

**VENDIM**  
**Nr.687, datë 18.6.2009**

**PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË FIROVE TË LEJUARA GJATË PROCESIT TË**  
**PËRPUNIM-MANIPULIMIT TË DUHANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, dhe të neneve 16 e 25 të ligjit nr.8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Mbeturinat e pashfrytëzuara, që krijohen në proceset e magazinimit, të përpunim-manipulimit të duhanit, si dhe humbjet e lëndës së thatë, si pasojë e shndërrimeve biokimike gjatë fermentimit, përbëjnë atë që quhet firo e lejuar.

Në procesin e përgatitjes së duhanit për treg, firot krijohen gjatë:

- a) ruajtjes në magazinë;
- b) përpunim-manipulimit dhe përgatitjes së tongave;
- c) fermentimit.
- a) Firo të lejuara gjatë ruajtjes në magazinë janë humbjet nga:
  - procesi natyral i fermentimit;
  - dëmtimet mekanike, në rrotullimin e dengjeve, për efekt ajrosjeje (allaburi);
  - myku i gjetheve të duhanit.
- b) Firo të lejuara gjatë përpunim-manipulimit janë humbjet:
  - gjatë ventilimit të gjetheve (largim të lëndëve inerte);
  - nga dëmtimet mekanike, gjatë seleksionimit dhe përpunimit të duhanit;
  - nga dëmtimet mekanike, gjatë bërjes së tongave.
- c) Firo të lejuara gjatë fermentimit janë humbjet:
  - për efekt të procesit artificial të fermentimit;
  - nga dëmtimet mekanike, gjatë përpunimit të tongave para, gjatë dhe pas fermentimit.

2. Niveli i firove të lejuara gjatë proceseve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për duhanet e tipit “Oriental” është si më poshtë vijon:

- a) Gjatë ruajtjes në magazinë deri 2.5%;
- b) Gjatë përpunim-manipulimit deri 5.3%;
- c) Gjatë fermentimit deri 3.2%;
- ç) Gjithsej deri 11%.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**